



GREENFARM sh.p.k

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 20-04.2007

Numri unik i indentifikimit(NIPT): K74727401G

Selia: Fshati Bubullime, Lushnje.

Objekti tregtar: Fidanishte

Pasqyrat Financiare Vjetore

2014

(Mbyllur më 31.12.2014)

Pasqyra financiare:	Individuale(jokonsoliduara)
Periudha kontabel:	Nga 01.01.2014 deri më 31.12.2014
Data e mbylljes:	21.03.2015
Monedha:	Leke
Shkalla e rrumbullakimit:	ne leke

Lushnjë, Mars 2015

Tabela e përmbajtjes

A. BILANCI KONTABEL	2
B. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
C. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	4
D. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	5
E. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	6-12

Bilanci kontabël
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shënime	Viti raportues 31.12.2014	Viti paraardhës 31.12.2013
A	AKTIVET		
I	Aktive Afatshkurtera		
	Aktive monetare	3 157,142	2,265,715
	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim	-	-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4 16,660,278	12,684,939
	Inventari	5 32,059,236	28,162,683
	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje të bimeve	-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	1,950,174	1,950,174
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)	50,826,830	45,063,511
II	Aktive Afatgjata		
	Investimet financiare afatgjata	-	-
	Aktive afatgjata materiale	6 49,381,506	51,172,954
	Aktivet afatgjata jomateriale	-	-
	Kapital aksionar i papaguar	-	-
	Aktive të tjera afatgjata	-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)	49,381,506	51,172,954
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)	100,208,336	96,236,465
B	DETYRIMET DHE KAPITALI		
I	Detyrime Afatshkurtera		
	Huamarrjet	7 10,819,966	10,120,256
	Huatë dhe parapagimet	8 31,534,248	37,706,398
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	-	-
	Provizionet afatshkurtra	-	-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)	42,354,214	47,826,654
II	Detyrime Afatgjata		
	Huatë afatgjata	9 53,461,792	45,126,646
	Huamarrje të tjera afatgjata	-	-
	Provizionet afatgjata	-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)	53,461,792	45,126,646
	Totali i Detyrimeve (I+II)	95,816,006	92,953,300
III	Kapitali		
	Kapitali i regjistruar (aksionar)	10 1,100,000	1,100,000
	Primi i aksionit	-	-
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)	-	-
	Rezerva statutore	-	-
	Rezerva ligjore	10 -	-
	Rezerva të tjera	10 2,183,165	1,100,638
	Fitimet(humbja) të pashpërndara	-	-
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11 1,109,165	1,082,527
	Totali i Kapitalit (III)	4,392,330	3,283,165
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)	100,208,336	96,236,465

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2014	Viti paraardhës 31.12.2013
1 Shitjet neto	11	13,054,256	12,545,572
2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Pu		700,000	
3 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dl		-	3,894,977
4 Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(3,105,200)	(5,215,096)
5 Kosto e punës	11		
Pagat e personelit		(1,669,546)	(1,558,909)
Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(278,814)	(260,338)
6 Amortizimet dhe zhvierësimet		(1,800,448)	(2,115,801)
7 Shpenzime të tjera		(2,003,259)	(1,164,440)
8 Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(8,857,267)	(10,314,584)
9 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-4-5-6-7-8)	0	4,896,989	6,125,965
10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11	-	-
12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		(3,563,170)	(4,510,954)
12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		27,548	(364,664)
12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-	-
13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(3,535,622)	(4,875,618)
14 Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	0	1,361,367	1,250,347
15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69	12	252,202	167,820
16 Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	11	1,109,165	1,082,527
17 Elementët e pasqyrave të konsoliduara		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti raportues 2014	Viti paraardhës 2013
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		1,361,367	1,250,347
Rregullime për:			
Amortizimin		1,800,448	2,115,801
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet		-	-
Shpenzime për interesa		3,563,170	4,510,954
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivi		(3,955,957)	(133,785)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		(3,896,553)	(1,733,139)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		(5,472,440)	2,272,720
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		(6,599,965)	8,282,898
Interesi i paguar		(3,563,170)	(4,510,954)
Tatim mbi fitimin i paguar		(271,584)	-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		(10,434,719)	3,771,944
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(9,000)	-
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		(9,000)	-
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		8,335,146	(4,483,648)
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		8,335,146	(4,483,648)
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		(2,108,573)	(711,704)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		2,265,715	2,977,419
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		157,142	2,265,715

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i regjistruar (aksionar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	1,100,000	-	449,895	650,743	2,200,638
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	1,100,000	-	449,895	650,743	2,200,638
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	1,082,527	1,082,527
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	714,589	(714,589)	-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	1,100,000	-	1,164,484	1,018,681	3,283,165
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	1,109,165	1,109,165
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	1,082,527	(1,082,527)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	1,100,000	-	2,247,011	1,045,319	4,392,330

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "Greenfarm" sh.p.k dhe jane firmosur nga:

Hartuesi

Sidorela BANI

Administratori

Ferdinant BANI



Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

"GREENFARM" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 20.04.2007 . Kapitali regjistruar eshte 1.100.000 dhe zotrohet nga ortaket e shoqerise Ferdinant Bani me 35% te kapitalit Alketa Bani me 10% te kapitalit, Roberto Troiani me 45% te kapitalit dhe Marina Di Buo me 10% te kapitalit.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise eshte krijimi i fidanishteve per prodhimin e bimeve e luleve dekorative te caktuara per pyje e perdorime te tjera per tregtim, eksportim e importimin e tyre.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare' dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2014 eshte zbatuar formati i SKK-2 .

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njeitin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kosos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2014 jane 1 euro=140.14 leke dhe 1 dollar=115.23 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2014 eshte 15% e ndryshuar nga periudha e mëparshme.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e perdorura janë në ndertesat 5% të vlerës fillestare dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës mbetur.

Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në bankë dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2014		Gjendja ne 31.12.2013	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	155,252	-	170,031	-
Arka ne leke	LEK	1,890	-	2,095,684	-
Shuma		157,142	x	2,265,715	x

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës respektive.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2014 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	11,211,286	6,899,156
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5,448,992	5,785,783
(iii) Instrumente të tjera borxhi	0	0
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	16,660,278	12,684,939

Ne "Llogari/Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar faturat e papaguara për shitjet që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit si dhe tepricat debitore të marrëdhënieve me furnitorët.

Ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" janë pasqyruar shumat prej 5.391.794 leke "Shteti-Tvsh e zbritshme" në muajin Dhjetor 2014 dhe shuma 49.889 leke përfaqëson "Shteti-tatim mbi fitimin" i paguar tepër më 31.12.2014, dhe "Shteti-dogana" në shumën 7.309 leke.

Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
(i) Lëndët e para	3,401,923	2,876,715
(ii) Prodhim në proces	13,007,235	14,095,855
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	15,650,078	11,190,113
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	32,059,236	28,162,683

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër përputhen me të dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2014. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares së ponderuar". Vlerat e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabel 2014 është 3.105.200 leke.

Llogaria e inventarit më 31.12.2014 në shumën 32.059.236 leke përfaqëson vlerën e kostos në blerje si dhe në vlerën e kostos në trajtimin dhe kultivimin e bimeve e pemeve dekorative në rritje, në këtë llogari është respektuar SKK – 13, i cili trajton të gjitha rastet e aktiveve biologjike.

5.1 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	1,950,174	1,950,174
Totali 2	1,950,174	1,950,174

Zeri "Parapagime dhe shpenzime të shtyra" janë shpenzime të cilat nuk janë renduar në vitet ushtrimore që do të rimerren si shpenzime në vitet pasardhës.

6 Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2014	15,000,000	6,444,223	6,357,611	25,809,132	53,610,966
Shtesat	-	-	0	9,000	9,000
Pakesimet	-	-	0	0	0
Kosto e AAM-ve 31.12.2014	15,000,000	6,444,223	6,357,611	25,818,132	53,619,966
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2014		628,312	1,062,469	747,231	2,438,012
Amortizimi ushtrimit		290,796	944,049	565,603	1,800,448
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	0	0	0
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2014	-	919,108	2,006,518	1,312,834	4,238,460
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2014	-	-	0	0	0
Shtesat	-	-	0	0	0
Pakesimet	-	-	0	0	0
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2014	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2014	15,000,000	5,815,911	5,295,142	25,061,901	51,172,954
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014	15,000,000	5,525,115	4,351,093	24,505,298	49,381,506

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2014. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbyljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2) Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

7 Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Huamarrjet	7	
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra		-
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	10,819,966	10,120,256
(iii) Bono të konvertueshme	-	-
Totali 2	10,819,966	10,120,256

"Kthimet/ripagesat e huave afatgjata" perfaqeson keset e kredise qe do te paguhen brenda 12 muajve te ardhshem te marre ne "Pro Credit Bank" dhe per vitin 2014 jane klasifikuar si detyrime afategjata.

8 Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Huatë dhe parapagimet	8	
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	30,538,901	34,037,320
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	927,961	3,631,266
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	67,386	37,812
(iv) Hua të tjera	0	
(v) Parapagimet e arkëtuara	0	0
Shuma	31,534,248	37,706,398

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2014 ne shumen 67.386 leke.

9 Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Huatë afatgjata	9	
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	53,461,792	45,126,646
(ii) Bonot e konvertueshme	0	0
Shuma	53,461,792	45,126,646

Shoqeria ka marre hua afatgjate nga Banka "Pro-Credit", llogari ne euro, me afat 10-vjecar. Teprica e kredise me 31.12.2014 eshte 38,648,324 leke, dhe shuma prej 10,819,966 leke eshte klasifikuar si hua afatshkurter ne rubriken e mesiperme 7 dhe pjesa tjetere ne vlere 27,828,358 leke si hua afategjate, vlere prej 25,133,434 leke jane hua te marre nga shoqeria.

10 Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2014 ai eshte 1.100.000 leke, i ndare ne 1.100 kuota me vlere nominale 1.000 leke/kuota. Gjate ushtrimit kontabel 2014 nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e regjistruar te shoqerise dhe ndryshime ne raportet zoterimit nga ortakët.

Me Vendim te Asamblese se Ortakut fitimi i realizuar per vitin 2013 ka kaluar ne rezervat e kapitalit.

11 Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0	0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	1,850,000	0
Te ardhurat nga shitja e mallrave	11,204,256	12,545,572
Te ardhurat te tjera(AAM)	0	0
Shuma	13,054,256	12,545,572

Të ardhurat nga shitja e sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Te ardhurat nga shitja e mallrave perfaqesojne shitjen e mallrave dhe materialeve te para. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit ne Vleren 700.000 leke pasqyron te ardhurat nga Grantet

▪ **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2014 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Shpenzimet e tjera paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
1 Furnitura		
Mirembajtje	11,466	-
Lende djegese	250,158	280,000
Transport		420,555
Shpenz.postare e telekomunikimi	15,000	
Shpenzime per sherbimet bankare	46,213	27,698
Shpenz.te tjera	11,667	
Shpenz.per licensa etj	600,833	
Personel jashte ndermarrjes	746,943	8,333
Total 1	1,682,280	736,586
2 Te tjera tatime dhe taksa		
Tatime te tjera	1,000	-
Total 2	1,000	-
3 Penalitete, gjoba dhe shperblime		
Penalitete per pagese me vonese kestet e kredive	319,979	427,854
Total 3	319,979	427,854
Shuma 1+2+3	2,003,259	1,164,440

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera:	-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667	(3,563,170)	(4,510,954)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669	27,548	(364,664)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	-	-
Shuma	(3,535,622)	(4,875,618)

"Shpenzime per interesa" ne vlere 3.563.170 leke jane interesat e maturuara dhe te paguara gjate vitit 2014 per huate e marre nga shoqeria .

Fitime nga kursi i kembimit per vitin 2014 jane 27.548 leke.

▪ **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2014 (000 leke)			Ushtrimi 2013 (000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi
Administrator, menaxher	1	312	52	1	420	70
Specialist me arsim universitar			-			-
Teknike			-			-
Puntore	6	1,358	227	5	1,139	190
	7	1,670	279	6	1,559	260

12 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2014 dhe 2013 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	1,361,367	1,250,347
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	319,979	427,854
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	-	-
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera	319,979	427,854
III PJESA E HUMBUES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	1,681,346	1,678,201
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	252,202	167,820
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	1,109,165	1,082,527

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13 Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, veç huase se marre nga ortaku nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

14 Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2014 dhe 2013 jane ndertuar sipas SKK-ve dhe jane plotesishte te krahasueshme.

